



# Buletini Mjedisor

## PREZANTOHET KOMUNIKIMI I TRETË I SHQIPËRISË NË KUADËR TË NDRYSHIMEVE KLIMATIKE



Shqipëria prezantoi Komunikimin e Tretë Kombëtar në Konventën Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (KKKBNK) - një proces që

kërkoj 3 vite punë dhe përfshiu aktorë nga disa institucione kombëtare, ekspertë të çështjeve të lidhura me klimën, akademikë, organizata të shoqërisë civile etj.

Të pranishëm në prezantimin e Komunikimit të Tretë Kombëtar ishin Ministri i Mjedisit, z. Lefter Koka, Përfaqësuesi i Përhershëm i PNUD-it në Tiranë, Brian Williams, përfaqësues nga ministri të linjës, si dhe specialistë e ekspertë që punojnë në fushën e mjedisit.

Në fjalën e tij Ministri Koka theksoi: "Në harkun kohor midis dy komunikimeve kombëtare, Shqipëria ka njohur mjaft ndryshime dhe zhvillime të rëndësishme në fushën e mjedisit, veçanërisht në sektorin e ndryshimeve klimatike. Prej të paktën 3 vitesh mjedisësit kthyer në qendër të vëmendjes së Qeverisë Shqiptare dhe politikave mjedisore po përpunohen gjithnjë e më shumë me legjislacionin e Bashkimit Europian dhe konventat ndërkombëtare në fushën e mjedisit".

Në vijim, z. Koka u ndal në masat e rekomanduara duke nënvizuar: "Një seri masash prioritare janë rekomanduar lidhur me reduktimin e gazeve serrë, uljen e kërkesës për energji dhe rritjen e furnizimit me energji duke kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm dhe duke bërë të mundur që Shqipëria të aktivizojë burimet që bazohen në mekanizmat politikë dhe të tregut. Në emër të Qeverisë Shqiptare ju siguroj për angazhimin e Shqipërisë si një partner e denjë në përpjekjet botërore për reduktimin e emetimit të gazeve serrë, me besimin e plotë se edhe

kontributi i një vendi në zhvillim, siç është Shqipëria, është i dobishëm në sfidën globale me detyrimet dhe përgjegjësitë që i takojnë vendit tonë, sipas Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara".

Brian Williams, Përfaqësues i Përhershëm i PNUD-it, gjatë fjalës së tij u shpreh: "Proçesi i përgatitjes së Komunikimit Kombëtar në Shqipëri ka qenë tejet i rëndësishëm për të integruar dhe përfshirë gjetjet e tij në strategjitë dhe politikën sektoriale. Nga Komunikimi i Parë Kombëtar e deri te Komunikimi i Tretë, ato kanë qenë instrumentet kryesore për mobilizimin e fondeve dhe të projekteve në fushën e ndryshimeve klimatike. Përveç Kontributit Kombëtar të Pikësnyuar (KKP), Komunikimi i Tretë Kombëtar ka mundësuar zhvillimin e Masave Zbutëse Kombëtare të Përshtatshme (MZKP), të Planifikimit Kombëtar të Përshtatjes ndaj Ndryshimeve Klimatike, të Strategjisë Kombëtare për Mjedisin dhe Ndryshimet Klimatike, si dhe të legjislacionit të lidhur me ndryshimet klimatike. I gjithë procesi i zhvillimit të Komunikimit të Tretë Kombëtar shërben për ngritjen e kapaciteteve institucionale dhe ndërgjegjësimin e publikut në Shqipëri për shqetësimet e ndryshimeve klimatike".

Ky dokument, qëllimi i të cilit është të informojë shtetet palë në Konventën Kuadër, vendimmarrësit dhe publikun shqiptar për prijet aktuale të ndryshimeve klimatike dhe pasojat e tyre, përmban një inventar të

shkarkimeve të gazeve me efekt serrë (GES) dhe të flukseve të tyre, si dhe përshkruan kapacitetet e Shqipërisë për të kontribuar në zbatimin e këtyre ndryshimeve dhe aftësitë e saj për t'u përshtatur me këto ndryshime.

Dokumenti është një detyrim i Shqipërisë si shtet palë. Dokumenti merr në shqyrtim pesë sektorë kryesorë, si energjia, proceset industriale, bujqësia, menaxhimi i mbetjeve, ndryshimi i përdorimit të tokës dhe pylltaria (NPTP), si dhe gazet GES me efekt të drejtpërdrejtë.

Vlerësimi parashikon një sintezë të studimeve ekzistuese dhe të reja për identifikimin e masave për përshtatje.

Raporti tregon se zona bregdetare e Shqipërisë mund të bëhet më e ngrohtë me kalimin e kohës për shkak të ndryshimeve klimatike. Po ashtu priten tendenca në rritje të temperaturave vjetore dhe sezonale, si në vlerat minimale, ashtu edhe në ato maksimale.

Të gjithë skenarët tregojnë një ulje të mundshme të reshjeve vjetore në krahasim me vitin 1990 për të gjitha horizontet kohore.

Shqipëria ka dorëzuar Kontributin Kombëtar të Pikësnyuar (KKP) në Shtator 2015. Në vijim të KKP-së, parlamenti shqiptar ratifikoi Marrëveshjen e Parisit në muajin korrik 2016, duke shënuar një hap madhor në drejtim të zbatimit të saj.

Hartimi i Komunikimit të Tretë Kombëtar ka qenë një sipërmarrje e përbashkët e Ministrisë së Mjedisit dhe Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim në Shqipëri, në kuadër të mbështetjes së ofruar nga Fondi Global për Mjedisin.

## QENDËR VIZITORESH NË PARKUN KOMBËTAR SHEBENIK-JABLLANICË



Ministri i Mjedisit, z. Lefter Koka, mori pjesë në inaugurimin e "Qendrës së Vizitorëve në Stëblevë", në Parkun Kombëtar Shebenik-Jabllanicë. Ngritja e kësaj qendre u financua nga qeveria italiane përmes zyrës së Bashkëpunimit Italian (Cooperazione Italiana). Ky projekt u realizua nga Ministria e Mjedisit, AKZM dhe IUCN.

Gjatë këtij aktiviteti ishte i pranishëm dhe z. Andrea Senatori, Drejtori i zyrës së Bashkëpunimit me Italinë, deputeti i zones, z. Taulant Balla, Kryetari i Bashkisë Librazhd, Kastriot Gurra, si dhe përfaqësues të tjerë nga pushteti vendor i zones. Parku kombëtar Shebenik-Jabllanicë, është një ndër parqet më të mëdhenj në vend, dhe me një afërsi të madhe gjeografike nga kryeqyteti. Ky park do të ketë për herë të parë një qendër vizitorësh me standarde bashkëkohore. Qendra do të shërbejë si një qendër informacioni për turistët vendas dhe të huaj, si dhe vizitorë të ndryshëm, për të promovuar gjerësisht vlerat e këtij parku. Gjithashtu, pjesë e qendrës do të jetë dhe muzeu, në të cilin do ekspozohen vlerat e parkut, si herbarët nga bimësia e këtij parku, foto historike nga kjo zonë; një kënd për traditat vendase, broshurat, hartat, fletëpalosjet e prodhuara për këtë park.

Ministri i Mjedisit, z. Lefter Koka, në fjalën e mbajtur falenderoi palën italiane për mbështetjen e vazhdueshme në fushën e mbrojtjes së mjedisit. Ai, gjithashtu, theksoi se "Kjo qendër informimi nuk do shërbejë vetëm turistëve vendas apo të huaj që do njihen tashmë më shumë me vlerat e këtij parku,

por theksoi se kjo qendër do i shërbejë dhe banorëve të zones, e veçanërisht fëmijëve të tyre, pasi ajo do jetë edhe një qendër edukimi për fëmijët, që do rriten duke vlerësuar çdo pasuri të florës dhe faunës që ofron zona e tyre. Fëmijët do të jenë ambasadorët më të mirë të këtij Parku. Doja të thosha se merita kryesore për mbrojtjen e këtij Parku dhe rigjallërimin të tij i shkon banorëve të përkushtuar të zonës, të cilët e kanë ruajtur ndër vite këtë pasuri natyrore".

Ministri Koka inkurajoi dhe vlerësoi Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (AKZM), si një institucion i ri i krijuar vetëm një vit më parë, por që po tregon një angazhim serioz në rigjallërimin e zonave të mbrojtura, për t'i kthyer ato në zona tërheqëse, si për turizmin vendas dhe atë të huaj.

Deputeti i zonës, Taulant Balla, vlerësoi punën e bërë nga Ministria e Mjedisit dhe theksoi se Parku Shebenik-Jabllanicë është më i mbrojturi në Shqipëri falë vetë banorëve, por edhe punës së bërë nga stafi i Ministrisë së Mjedisit.

Drejtori i Kooperacionit Italian në Shqipëri, z. Andrea Senatori, siguroi mbështetjen e vazhdueshme të qeverisë italiane në projektet e mjedisit që po ndërmerren qeveria shqiptare.

Në Parkun Kombëtar Shebenik-Jabllanicë, Agjencia e Zonave të Mbrojtura ka përfunduar hartimin e planit të menaxhimit. Gjatë kësaj periudhe 1 vjeçare është mundësuar monitorimi i plotë i hapësirës së parkut, janë markuar 60 km shtigje, të cilat përdoren nga turistët që duan të zhvillojnë sportin e ecjes në zona malore, janë rreth 300 km

të hedhura në GIS për turistë të huaj dhe vendas, si dhe janë ndërtuar 4 vend-pushime të vogla për vizitorët.

Është dyfishuar gati numri i vizitorëve të parkut krahasuar me vitin 2015. Gjithashtu, si efekt i moratoriumit vjetër në rritje e ndjeshme e faunës në këtë zonë. Në këtë park është punuar dhe për përgatitjen e guidave natyrore. Janë zhvilluar trajnime me një grup prej 20 të rinjsh, banorë të zonave përreth, si dhe rreth 30 nxënës nga shkolla Rrajçë dhe Dorëz, të cilët janë quajtur dhe Ambasadorët e Parkut Kombëtar Shebenik-Jabllanicë. Këta të rinj janë trajnuar për të mundësuar udhëheqjen e grupeve të turistëve në këtë park.

Po punohet nga Ministria e Mjedisit nëpërmjet Agjencisë së Zonave të Mbrojtura për të mundësuar ngritjen e Qendrave të Vizitorëve dhe në zona të tjera të mbrojtura nëpër Shqipëri.

Kështu, vetëm disa ditë më parë u inagurua Qendra e Vizitorëve Lumi Buna – Velipojë, së bashku me Kullën e Vrojtimit.

Gjithashtu po rikonstruktohen 4 Qendra Vizitorësh në parqet Kombëtare Dajt, Llogara, Divjakë-Karavasta, Theth, si dhe po rikonstruktohen dy zyra të administratës së zonave të mbrojtura në Qafë-Shtamë dhe Valbonë.

Në 2015 u inaguruan dhe 2 qendra vizitorësh, në Prespë të Vogël dhe në Prespë të Madhe me fonde të KfW.

#### 4 TETORI—DITA BOTËRORE E KAFSHËVE

4 Tetori është dita Botërore e Kafshëve. Në kuadër të kësaj dite Ministri i Mjedisit, z. Lefter Koka dha mesazhin: “Sot në Ditën Botërore të Kafshëve, më shumë se kurrë vlen të kuptojmë se çdo veprim bën diferencën dhe se bota nuk mund të jetë më e mirë pa përkushtimin tonë ndaj natyrës dhe kafshëve, për ruajtjen e habitateve dhe ekosistemeve. Ministria e Mjedisit në këto tre vite ka dhënë kontributin e saj të çmuar për ruajtjen dhe pasurimin e faunës së egër në vendin tonë.

Moratoriumi i gjuetisë që në vitin e parë të zbatimit të tij ka dhënë rezultate të shkëlqyera, ndërsa ndërgjegjësimi mjedisor

ka shënuar përparime të dukshme falë edhe kontributit të medias.

Pelikani Kaçurrel tashmë është një nga shpendët më popullore në Shqipëri, ndërsa Ariu i Murrme nuk do të jetë më viktimë e robërimit për qëllime përfimi, falë nismave tona në këto 3 vite.

Një projekt i rëndësishëm është iniciuar për të bërë inventarizimin e faunës në vendin tonë, me të dhëna të munguara prej shumë vitesh.

Inkurajojmë shoqatat mjedisore, komunitetet, të rinjtë dhe fëmijët, bizneset dhe individët që të bëjnë çmos për një të ardhme më të mirë të faunës sonë!”

#### PAK HISTORI

Kjo ditë e ka origjinën nga Heinrich Zimmermann, një shkrimtar dhe publicist Gjerman, i cili ishte dhe një aktivist i njohur për mbrojtjen e kafshëve. Për herë të parë kjo ditë u festua në 4 Tetor më 1929. Fillimisht në këtë ditë ndërmerreshin aktivitetet në mbrojtje të kafshëve vetëm në Austri, Gjermani, Zvicër dhe Çekosllovakia. Çdo vit Zimmermann punonte për të promovuar këtë lëvizje, por vetëm në kongresin e organizatave për mbrojtjen e kafshëve në Maj 1931, në Firence të Italisë, u vendos që 4 Tetori të jetë Dita Botërore e Kafshëve.

#### VIJON PUNA PËR KUJDESIN E ARINJVE



Një ari 10-muajsh mbahej në robëri në zonën e Qafë-Krrabës.

Ky ari pasi u lokalizua si vendndodhje, u sekuestrua nga Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit dhe iu nënshtrua ekzaminimeve të nevojshme nga veterinerët të huaj, të cilët bënë dhe vaksinimin e ariut.

Pas konfiskimit, ariu i quajtur Tedi është dërguar në Kopshtin Zoologjik të Tiranës, ku do të qëndrojë përkohësisht deri në gjetjen e një strehe jashtë vendit.

Ndërkohë shtetasi, që

mbante në robëri ariun për qëllime fitimëshe të çuar për ndjekje penale.

Vetëm gjatë vitit 2016 numërohen 15 arinj të çliruar nga robëria dhe që janë transferuar apo që janë në proces transferimi, në strehimore të veçanta jashtë vendit. Kjo është bërë e mundur falë punës së inspektorëve të mjedisit, specialistëve të Ministrisë së Mjedisit dhe bashkëpunimit me shoqata të ndryshme mjedisore, që operojnë në këtë fushë.

Transferimi i arinjve të mbajtur në robëri vjen në kuadër nismës së Ministrisë së Mjedisit për të

adresuar njëherë e mirë këtë problematikë të faunës së egër në vendin tonë.

Përveç konfiskimit dhe strehimit të arinjve të mbajtur në robëri, Ministria e Mjedisit është duke punuar edhe për realizimin e identifikimit të plotë dhe matrikullimin e të gjithë arinjve, që mbahen në robëri nëpërmjet vendosjes së mikroçipeve dhe një fushate ndërgjegjësuase kundër fenomenit të mbajtjes në robëri të arinjve në Shqipëri.

#### KREU I ISHMP-SË AGASI: 1519 INSPEKTIME VETËM NË 60 DITË NGA INSEKTORIATI I POLICISË PYJORE



Strukturat e Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve (ISHMP) kanë kryer 1519 inspektime në periudhën Gusht—Shtator 2016, në gjithë vendin, raportohet nga kreu i ISHMP-së, z. Ergys Agasi.

Nga këto: 1178 inspektime në pyje e kullota, 224 inspektime në fondin e gjuetisë, 67 në subjekte dhe 50 të tjera në fusha të ndryshme, ku ISHMP ushtron veprimtarinë e tij.

Janë vendosur gjithsej 49 masa administrative në kundrvajtje të ndryshme, dënim me gjobë në vlerën 31.837.000 lekë ose rreth 230 mijë euro dhe me vlerë dëmi 3,736,349,000 lekë.

Në 21 raste janë sekuestruar 148 m<sup>3</sup> dru zjarri dhe lëndë punimi. Gjatë kësaj periudhe kemi pasur 12 raste zjarri (vetëm në Gusht) me 177.2 ha sipërfaqe të djegur.

Në zbatim të ligjit nr. 10006, datë 23.10.2008, “Për mbrojtjen e faunës së egër” janë kryer nga ISHMP procedurat ligjore për sekuestrimin dhe dorëzimin pranë Ministrisë së Mjedisit të 7 arinjve të moshave të ndryshme.

Drejtorja e Policisë Pyjore (DIPP), së bashku me Drejtorinë e Mjedisit (DIM), kanë ngritur një grup pune (Task-Force), e cila po realizon kontrollin në të gjitha subjektet që shfrytëzojnë burimet natyrore për të cilat do të nxjerrë një raport publik me

përfundimin e tij në rang vendi.

Kreu i ISHMP-së, z. Ergys Agasi, siguron të gjithë qytetarët shqiptarë, si dhe çdo palë, aktor apo grup interesi se kontrolli mbi pyjet vazhdon të jetë rigoroz dhe se çdo rast paligjshmërie është ndëshkuar e do të vazhdojë të ndëshkohet maksimalisht, sipas ligjit në fuqi.

Ai kërkon bashkëpunimin e ngushtë të qytetarëve shqiptarë me strukturat e ISHMP-së për identifikimin e rasteve të shkeljeve dhe abuzimit me ligjin dhe mjedisin, me qëllim sigurimin e një mjedisi të pastër e shëndetshëm për të gjithë.

#### VENDIMET E KOMISIONIT PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS 2016

Nr.	Subjekti	Administratori	Aktiviteti	Vendndodhja	Hartoi Dosjen	Vendimi
1	Bashkia Tiranë	Erion Vela	VP Rigjallërimi i qendrës së Tiranës “Sheshi Skenderbej”	Tiranë	"ECCAT" SHPK	Vendim për VNM Paraprake
2	GTS Gazra Teknike Shqiptare	Besnik Halili	VTH Prodhim gazrash teknike (për salla operacioni)	Vaqarr, Tiranë	Prof. Dr. Sulejman Sulçë	Deklaratë Mjedisore
3	Platinum ALB	Renato Beqiraj	VP Ndërtim kapanoni	Udenisht, Pogradec	Demir Kullolli	Vendim për VNM Paraprake
4	Danish Green Garden	Denada Shtylla	VP Ndërtim kapanoni	Krujë, Lushnjë	Xhevair Dermysli	Vendim për VNM Paraprake
5	VIP Sofa	Sulejman Hoxha	VP Ndërtim kapanoni (për prodhim mobiljesh)	Aliban, Vlorë	"STUDIO COMERCIR"	Vendim për VNM Paraprake
6	Mele	Petra Mele	VP Godinë banimi 3 kt	Korçë	Elvis Xhaferri	Vendim për VNM Paraprake
7	Ageta dhe Bajrami	Ali Kaci	VP Ndërtim i hidrocentrali HEC Borie-Lurë	Dibër	"TAULANT" SH.P.K	Vendim për VNM Paraprake
8	Albchrome	He Min	VP Shfrytëzim i mineralit të kromit me galeri nëntokësore	Dibër	Eko-Studio-Projekt shpk	Vendim për VNM Paraprake
9	Bashkia Sarandë 691	Florjan Koka	VP - Ngritja e Eco Kampusit	Sarandë	LAURA FERATI	Vendim për VNM Paraprake
10	Fakle	Fiqiri Farroku	VP Ndërtim godinë banimi 1-3 kat	Durrës	"Studime Projektme Min-crare", Arjan Bala	Plotësim Informacioni
11	Favina 1	Viktor Qylafi	VP Ndërtim idhe operim i HEC Kamenicë	Korçë	ECA STUDIO	Vendim për VNM Paraprake
12	Lulzim Gjergji	Lulzim Gjergji	VP Ndërtim kapanoni Servis	Tiranë	Gëzim Agasi	Vendim për VNM Paraprake
13	NIKA BL	Sokol Bushgjoka	VP Shesh i materialeve inerte	Kalimash Kukës	Eko-Studio-Projekt shpk	Deklaratë Mjedisore
14	Sali Vranezi	Sali Vranezi	VP Ndërtim Stalle për bagëti të imta, Peshkopi	Dibër	"ROALB STUDIO" SHPK	Vendim për VNM Paraprake
15	Sami Debrova	Sami Debrova	VP Ndërtim magazine për grumbullimin, përpunimin, ambalazhimin dhe ruajtjen e perimeve dhe frutave	Dushk, Elbasan	Ing. LILA KARAJ	Vendim për VNM Paraprake
16	Struktura 2002	Andi Jovani	VP Kapanon industrial	Xhafzotaj, Durrës	"ARCHITECTURAL DESINGER" SHPK	Vendim për VNM Paraprake

## MINISTRI KOKA : - "BREZI I RIËSHËTË THEMELI I SË ARDHMES SË SIGURTË PËR MBROJTJEN E MJEDISIT NË SHQIPËRI"



31 Tetor 2016 – Ministri i Mjedisit, z. Lefter Koka, shpërndau çmimet për tre fëmijët fitues të Konkursit Kombëtar të Pikturës, që u shpall në kuadër të javës Europiane të Lëvizshmërisë. Z. Koka pasi i falenderoi fëmijët për angazhimin e tyre theksoi se "Ndërgjegjësimi i brezave të rinj për një mjedis më të pastër është themeli i të ardhmes mjedisore në Shqipëri. Do të jenë këta të rinj që me kontributin e tyre të drejtëpërdrejtë do të mund të ndryshojnë mendësinë e prindërve të tyre dhe gjithë shoqërisë, për atë se si të gjithë me duhet të angazhohemi në mbrojtje të Mjedisit për një jetë më cilësore dhe të shëndetshme."

Ky konkurs u shpall nga Ministria e Mjedisit me mbështetjen financiare të projektit IBECA, me temë: "Transport inteligjent - ekonomi e fortë".

Në këtë konkurs morën pjesë me punimet e tyre në teknika dhe zhanre të ndryshme mbi 150 nxënës nga shkollat 9-vjeçare në rang Republike. Tre nxënës u vlerësuan me çmime për punimet e tyre dhe mesazhin e qartë që përcillnin në kuadër mesazhit që përcjell Java Evropiane e Lëvizshmërisë.

Fillimisht u bë një për zgjedhje në lidhje me mesazhin që fëmijët kishin përcjellë nëpërmjet artit. Për përzgjedhjen e 3 çmimeve fituese u ngrit një juri pranë Galerisë Kombëtare të Arteve, e kryesuar nga z. Artan Shabani, Drejtor i GKA.

Fituesit e këtij konkursi ishin: në vend të parë moketi i

realizuar nga Entela Zenelaj; në vend të dytë punimi nga Ildri Mustafaj dhe çmimi i tretë për Robert Nelaj. Në fund të aktivitetit, përfaqësues të projektit IBECA dhe Ministrisë së Mjedisit dorëzuan çmimet për 3 fituesit, nga një biçikletë për secilin. Ne po ju sjellim disa nga pikturat më të vlerësuara:



**Entela Zenelaj**, 13 vjeç, shkolla Ali Podrimja, Bajram Curri. **Fituesja e çmimit të parë.**

Mesazhi: *Trafiku është kaos dhe shkatërron gjithëka, përdorni transportin publik dhe qytet do ndihet më mirë.*

### Vlerësimi i Galerisë Kombëtare të Arteve:

Metodë projektuale e mirë, me një vizion të fokusuar në zhvillimin urban duke respektuar natyrën dhe zonat e gjelbërta.



**Ildri Mustafaj**, 14 vjeç, shkolla Ali Podrimja Bajram Curri. **Fituesi i çmimit të dytë.**

Mesazhi: *Në botën që na rrethon unë kam bërë zgjedhjen që mbron mjedisin dhe mësiguron një jetë më të sigurt.*

### Vlerësimi i Galerisë Kombëtare të Arteve:

Mesazhi edukativ për rritjen e brezit të ri. Shumë e rëndësishme të edukojmë sot fëmijët për të pasur nesër një mjedis të sigurt

**Robert Nelaj**, 14 vjeç, shkolla Ali Podrimja, Bajram Curri. **Fitues i çmimit të tretë.**

Mesazhi: *Të gjithë janë të ndërgjegjshëm se përdorimi i mjeteve*




*mjedisore sjell një jetë më të mirë, por pak njerëz i përdorin ato.*

### Vlerësimi i Galerisë Kombëtare të Arteve

Mesazhi të drejtëpërdrejtë, tregon qartë gasjen e njeriut me natyrën dhe kobën dhe respektin që në dubet t'i dedikojmë asaj. E pasur me ngjyra

**Alma Bajra**, 14 Shkolla Hasan Riza Pasha, Shkodër.


*Për një botë më të gjelbëruar, përdorni transportin që mbron mjedisin.*



**Amela Bekteshi**, 14 Hasan Riza Pasha, Shkodër. *Mesazhi: Nafta dhe benzina po helmon jetën tonë, mënjanojini ato për të pasur një jetë më të mirë.*

**Suad Lici**, 10 vjeç, shkolla Hasan Riza Pasha, Shkodër.

Mesazhi: *Përdor biçikletën dhe kështu mbron mjedisin dhe veten.*



**Rilinda Zefi**, 13 vjeç, shkolla Ali Podrimja, Bajram Curri.

Mesazhi: *Ku nuk ka makina ka gjelbërim, ajër të pastër dhe kënaqsi estetike. Kështu e dua një shkollën time*

## PREZANTOHET DRAFT PLANI PËR NDOTËSIT ORGANIKË TË QËNDRUESHËM

Më 13 Tetor 2016, në Tiranë u zhvillua takimi me grupet e interesit për prezantimin e "Planit të parë të zbatimit të Ndotësve Organikë të Qëndrueshëm (NOQ)". Në këtë takim mermin pjesë përfaqësues nga Ministria e Bujqësisë, përfaqësues nga Ministria e Mjedisit, përfaqësues nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, përfaqësues nga Drejtoritë Rajonale të Mjedisit, përfaqësues nga Universiteti Bujqësor, Kamëz.

Takimi u hap nga z. Pëllumb Abeshi, Drejtor i Përgjithshëm i Politikave të Mjedisit dhe Jtësisimit të Prioriteteve në Ministrinë e Mjedisit, i cili theksoi se ky plan është konceptuar si një nevojë për rishikimin e planit ekzistues të vitit 2006. Ky rishikim ka ardhur edhe se në këto vite Konventa e Stokholmit ka përditësuar listën e NOQ-eve. Në këtë plan janë parashikuar detyra për institucione të ndryshme, detyrat e të cilëve janë të lidhura me fushën e kimikateve, të tilla si: Ministria e Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Inspektoriati i Mjedisit, etj

Prezantimin e draftit të hartuar e mbajti, z. Fredi Braushi, konsulent, i cili u fokusua kryesisht në vlerësimin e gjendjes së këtyre ndotësve në Shqipëri, si dhe në strategjinë që duhet të ndjekim dhe planin e veprimit që duhet të ndërmerri Shqipëria për Ndotësit Organikë të Qëndrueshëm (NOQ).

Më konkretisht në këtë draft plan janë trajtuar çështjet si përditësimi i të dhënave mbi gjendjen (inventarin) e NOQ të evidentuar gjatë raportit të parë të 2006; Inventari i NOQ të rinj që janë pjesë e Konventës së Stokholmit për NOQ-et të futur pas vitit 2006; Evidentimi i vendeve të mbetjeve dhe produkteve që mund të kenë në përmbajtje

NOQ të rinj.

Z. Braushi theksoi se "Qëndrueshmëria e NOQ-eve në mjedis shkon deri në dhjetëra vite ndaj ky plan që të jetë i zbatueshëm duhet të jetë sa më realist, gjithashtu është e rëndësishme që edhe përgjegjësia institucionale të këtë mundësi të ndahet".

Gjatë prezantimit u nda shqetësimi që në Shqipëri nuk ekziston një laborator i certifikuar për kryerjen e analizave të NOQ-eve. Agjencia Kombëtare e Mjedisit që kryen monitorime, momentalisht nuk kryen analiza për këto lloje sedimentesh.

Në fund të prezantimit u diskutuan me të pranishmit disa rekomandime me qëllim përmirësimin e këtij procesi, ku një ndër sugjerimet ishte edhe përfshirja e bazës së re ligjore të kimikateve të miratuar gjatë vitit 2016.

Ky draft plan është hartuar në kuadër të Projektit të financuar nga UNEP, "Rishikimi dhe përditësimi i Planit Kombëtar të Veprimit në kuadër të Konventës së Stokholmit për Ndotësit Organikë të Qëndrueshëm (NOQ) në Shqipëri".

Ky draft Plan do iu dërgohet të gjitha Ministrive të linjës për të marrë mendim dhe më pas do i nënshtrohet dhe dëgjësës së publikut.

Ndotësit Organikë të Qëndrueshëm (NOQ) janë lëndë kimike të qëndrueshme në mjedis, që bio-akumulohen nëpërmjet zinxhirit ushqimor dhe paraqesin rrezik sepse kanë efekte të dëmshme për shëndetin e njerëzve dhe mjedisin. Duke pasur parasysh bartjen e këtyre lëndëve në largësi të mëdha, deri në vende ku nuk janë përdorur ose prodhuar ndonjëherë, si dhe kërcënimin më pas për

mjedisin e tërë rruzullit tokësor, bashkësia ndërkombëtare ka bërë thirrje për masa të ngutshme, me synimin që të pakësohet dhe të eliminohet shkarkimi i këtyre lëndëve në mjedis.

Kur u bë e qartë se NOQ-të ishin shumë të rrezikshme dhe se duheshin ndërmarrë masa të ngutshme në të gjithë botën, UNEP-i ndërmori hapat e duhur për të përgatitur një instrument ligjor ndërkombëtar, me efekt detyrues, i cili do të "përcaktonte rrugën për një të ardhme pa NOQ të rrezikshme". Rezultat i këtyre përpjekjeve është Konventa e Stokholmit për Heqjen nga Përdorimi dhe Eliminimin e Ndotësve Organikë të Qëndrueshëm. Kjo Konventë është një traktat global për mbrojtjen e shëndetit të njerëzve dhe të mjedisit nga ndotësit organikë të qëndrueshëm.

Ajo u miratua më 22 maj 2001 në Konferencën e Palëve në Stokholm dhe hyri në fuqi më 17 maj 2004, sipas nenit 26 të po kësaj konvente. Bashkimi Evropian, i cilështë palë në këtë Konventë, ka miratuar Politikën e vet në lidhje me administrimin e NOQ-ve, politikë, që do të jetë e detyrueshme edhe për vendet e reja që do të hyjnë në BE. Shqipëria e ka nënshkruar Konventën më dhjetor 2001 dhe e ka ratifikuar atë në tetor 2004.

Konventa e NOQ-ve parashikon një varg detyrimesh që duhet apo nxiten të ndërmerri Palët, ndër të cilat janë përcaktimi i pikave fokale kombëtare, kujdesi për shkëmbimin e informacionit, dhënia e ndihmës teknike, zhvillimi dhe lehtësimi i ndërgjegjësimit dhe pjesëmarrjes së publikut, konsultimi dhe arsimimi, nxitja e kërkimit shkencor dhe e monitorimit, si edhe raportimi "në intervale kohorë periodike".



Kjo pikturë është punuar nga fëmija më i vogël pjesëmarrës në Konkursin Kombëtar të Pikturës, që u shpall në kuadër të javës Europiane të Lëvizshmërisë.

Faleminderit Dionis !

SEKTORI I TRANSPARENCËS DHE KOMUNIKIMIT  
Email: info@moe.gov.al

## DËGJESAT E PUBLIKUT GJATË MUAJIT SHTATOR

Ministria e Mjedisit në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura po organizon një proces konsultativ të gjërë për draft ligjin për Zonat e Mbrojtura. Ky proces konsultativ po organizohet në një sërë qytetesh pranë zonave të mbrojtura.

Kështu, ditën e hënë, datë 24.10.2016, në ambientet e zyrave të Administratës së Zonave të Mbrojtura, Shkodër u zhvillua dëgjesa publike për konsultimin e projektligjit “Për Zonat e Mbrojtura”. Në këtë takim merrnin pjesë përfaqësues nga Ministria e Mjedisit, përfaqësues nga Administrata e Zonave të Mbrojtura për qytetet Lezhë, Shkodër, Kukës; përfaqësues nga Bashkia Shkodër; specialistë pyjesh nga Bashkia e Vaut të Dejës; përfaqësues nga Universiteti i Shkodrës; përfaqësues të zyrës konsulente; përfaqësues nga OJF Shkodër.

Takimi u hap nga Znj. Adriana Petri, Drejtore e Menaxhimit, Projekteve dhe Monitorimit, pranë Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, e cila bëri një prezantim të përgjithshëm të projektligjit duke shtruar një sërë pyetjesh mbi: nevojën për këtë ligj, cilat do të jenë ndryshimet që do të sjellë ligji dhe si janë ndërtuar ndryshimet e tij.

Projektligji i ri ka për objekt shpalljen, ruajtjen, administrimin, menaxhimin, përdorimin e qëndrueshëm të zonave të mbrojtura dhe të burimeve të tyre natyrore e biologjike në bazë të parimit të zhvillimit të qëndrueshëm, për të garantuar përbushjen e funksioneve mjedisore, ekonomike, sociale kulturore, në interes të të gjithë shoqërisë, si dhe përcaktimi i përgjegjësjve të institucioneve publike, dhe personave fizik/juridik privat për ruajtjen dhe administrimin e qëndrueshëm të tyre.

Ky ligjësjhtë bazuar në ligjin aktual dhe hartimi i

tijësjhtë bazuar në problematikat që ai ka sjellë në të shkuarën në praktikën e vëndit tonë. Pas 11 vjetësh nga ligjit ekzistues të vitit 2005, ky projekt ligji do të sjellë risi në strukturën, si edhe në zonimin, ndarjen e cila bëhet sipas interesit kombëtar dhe kërkesave që vijnë nga organizmat ndërkombtare, ndërsa shkalla e mbrojtjes do të bëhet me nënzonim.

Struktura e re e AdZM-së do të ketë një fond të veçantë, i cili do të mblihdhet nga të ardhurat dhe donatorët, si edhe kompetenca të reja për rangersat të cilët do të ushtrojnë kompetenca të policisë gjygsore. Më pas dëgjesa u vazhdua me pyetjet nga të pranishmit.

Kështu një nga çështjet e ngritura nga të pranishmit ishte problem i mbivendosjeve të kopetencave në procesin e inspektimit.

Nga zyra konsulente qësjhtë marrë me hartimin e draftit, u shpreh se do të rishikohen kompetencat e secilit organ për të shmangur mbivendosjen, por shtoi se sjhtë menduar në këtë mënyrë për të shmangur monopolin, duke vendosur që një organ të kryjë kontrollin dhe tjetri gjobëvënie.

Një nga shqetësimet e të pranishmëve ishte për qartësimin e rolit të Administratës së Zonave të mbrojtura.

Nga konsulentët u sqarua se në nenin 3 të projektaktit, janë shpjeguar qartë kompetencat e AdZM-së.

Të pranishmit sollën eksperincën e tyre duke propozuar ndryshime në disa pika të këtij projekt akti.

Nga shoqëria civile pati një propozim që procesi i edukimit brenda zonave të mbrojtura, të shtohet edhe togfjalëshji palët e interesuara (vullnetarizimi) tek pjesa e edukimit.

Ditën e mërkurë, datë 26.10.2016, në ambientet e zyrave të Administratës së Zonave të Mbrojtura, Librazhd u zhvillua dëgjesa publike për konsultimin e projektligjit “Për Zonat e Mbrojtura”. Në këtë takim merrnin pjesë përfaqësues nga Ministria e Mjedisit; Përfaqësues nga Administrata e Zonave të Mbrojtura për qytetet: Elbasan, Korçë, Dibër, Durrës dhe Tiranë; përfaqësues nga nga Inspektoriati Elbasan; përfaqësues nga Universiteti i Elbasanit, Fakulteti i Shkencave; përfaqësues të zyrës konsulente; përfaqësues nga OJF: Shoqata ARGI-EN, Egnatia, Shoqata e gruas dhe Klubi Ekologjik Elbasan.

Takimi u hap nga Z. Sulejman Xhepa, Shef Menaxhimi, pranë Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, i cili bëri një prezantim të përgjithshëm të projektligjit së bashku me përfaqësuesen nga zyra konsulente, të cilët hapën rrugën për diskutime të lira. Një nga komentet e bëra nga të pranishmit ishte një lidhje me harmonizimin e termave midis zonimit dhe nënzonimit.

Të pranishmit u shprehën se zona qëndrore sjhtë më e rëndësjshmjja dhe duhet rregulluar shkalla e mbrojtjes, dhe sugjeruan kthimin tek nënzondarja e ligjit aktual. Gjithashtu u pranua që në ligj janë parashikuar aktivitete që gjenerojnë të ardhura, por sipas tyre duhet të specifikohet gjithashtu edhe sistemi i tarifimit, i cili duhet të jetë i ndryshëm nga ai fondit kullosor si edhe brenda këtij sistemi të detajohet për popullsinë e zonës. Pati dhe një propozim të termi rangers të zevëndësohet me rojtat pylli.

Më pas dëgjësas vijuan dhe në qytetin e Vlorës dhe në qytetin e Tiranës. Komentet po mblihdhen nga hartuesit e projekt ligjit dhe do merren parasysh gjatë procesit të rishikimit.

### NË RËTË NUMËR

PREZANTOHET KOMUNIKIMI I TRETË I SHQIPËRISË NË KUADËR TË NDRYSHIMEVE KLIMATERIKE - FQ 1

KREU I ISHIMP AGASË: 1519 INSPEKTIVE VETËM NË 60 DITË NGA INSPEKTORIATI POLICISË PYJORE - FQ 2

MINISTRI KOKA :- "BREZI I RI SJHTË THEMELI I SË ARDHMES SË SIGURT PËR MBROJTEN E MJEDISIT NË SHQIPËRI" - FQ 3

DËGJESAT E PUBLIKUT GJATË MUAJIT SHTATOR - FQ 4

*“Misioni i Ministrisë së Mjedisit, është të hartojë dhe propozojë politika, strategji dhe plane veprimi për mbrojtjen dhe administrimin e mjedisit dhe pyjeve në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm, përmirësimi të cilësisë së jetës dhe të integritetit të vëndit në Bashkimin Evropian. Përbushja e këtij misioni do të realizohet duke marrë pjesë, nxitur dhe bashkënduar veprimtaritë, të cilat çojnë në zhvillime e mirëqenie afatgjata, duke mbrojtur natyrën dhe sensibilizuar opinionin publik”.*